



Pursuant to instruction of the Single Judge KSC-BC-2020-07/CRSPD4 of 15 October 2020, reclassified as PUBLIC.

**Numri:** KSC-BC-2018-01

**Vendos:** Gjykatësi i vetëm  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Parashtrues:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 25 shtator 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*

---

**Njoftim i arrestimit sipas rregullës 55(4)**

---

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

1. Në përputhje me rregullën 55(4) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ('Rregullorja')<sup>1</sup>, kur një person arrestohet në Kosovë në bazë të një fletarrestimi të lëshuar prej Dhomave të Specializuara, autoritetet kompetente informojnë pa vonesë Administratorin, i cili njofton menjëherë Kryetarin, panelin dhe palët. Në përputhje me sa më lart, Administratorja njofton për arrestimin e z. Hysni Gucati ('z. Gucati') në Kosovë prej Zyrës së Prokurorit të Specializuar ('ZPS').

2. Më 24 shtator 2020, gjykatësi i vetëm lëshoi një vendim rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* në të cilin miratoi kërkesën e ZPS-së për lëshimin e një fletarrestimi dhe urdhri për transferim ('vendimi për arrestim dhe transferim').<sup>2</sup> Në vendimin për arrestim dhe transferim, gjykatësi i vetëm urdhëroi ZPS-në që të kryente dorëzimin dhe zbatimin e fletarrestimit në Kosovë.<sup>3</sup>

3. Më 25 shtator 2020, afërsisht rreth orës 13:05, ZPS-ja informoi Administratoren se z. Gucati ishte arrestuar nga ZPS-ja në Kosovë më 25 shtator 2020.

4. Në përputhje me vendimin për arrestim dhe transferim, Administratorja do t'i dorëzojë gjykatësit të vetëm raport lidhur me arrestimin dhe transferimin e z. Gucati.<sup>4</sup>

5. Ky njoftim parashtrohet si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, në përputhje me klasifikimin aktual të vendimit për arrestim dhe transferim.

**Numri i fjalëve në origjinal: 249**

/nënshkrim/

---

**Dr. Fidelma Donlon**  
**Administratore**

E enjte, 25 shtator 2020

Në Hagë, Holandë

---

<sup>1</sup> Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, ndryshuar më 29 dhe 30 prill 2020.

<sup>2</sup> Vendim mbi kërkesën për lëshimin e fletarrestimeve dhe urdhrave për transferim, KSC-BC-2018-01/F00128, 24 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>3</sup> KSC-BC-2018-01/F00128, para. 36(c).

<sup>4</sup> KSC-BC-2018-01/F00128, para. 36(f).